



**BASHKIA DEVOLL**  
**DREJTORIA E SHERBIMEVE FINANCIARE DHE BUXHETIT**  
**SEKTORI I PLANIFIKIMIT TE BUXHETIT**

**RELACION**  
**MBI**  
**PROJEKT BUXHETIN E VITIT 2023**

## I. VIZIONI I ZHVILLIMIT DHE STRATEGJIA TERRITORIALE

Bashkia Devoll hyrje e vendit, me një identitet të njohur në sajë të produkteve bujqësore, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit natyror, ka kushte banimi cilësore, është një destinacion ekoturizmi në nivel kombëtar dhe ofron mundësi për bujqësinë, turizmin dhe industrinë."

### HYRJE

Në Bashkinë e Devollit, sektori i bujqësisë dhe i përpunimit është që të jetë një sektor i rëndësishëm zhvillimi. Përshtatja e prodhimit me kërkesat e tregut, modernizimi i infrastrukturës mbështetëse, zgjerimi në tregje të reja. Në fushën e turizmit , kthimi i saj në destinacion ekoturizmi në nivel kombëtar, duke shfrytëzuar trashëgiminë e saj kulturore dhe mjedisin natyror dhe duke nxitur veprime në lidhje me forma të buta të turizmit alternativ si turizmi malor, agroturizmi etj. Duke pasur parasysh dhe pozicionin e saj si hyrje e Shqipërisë do të mund të krijojë bashkëpunim rajonal dhe ndërkombëtar me qëllim lidhjen dhe zhvillimin e rrjeteve turistike tematike, si dhe promovimin e zonës së mbrojtur ndërkombëtarisht të Parkut Kombëtar të Prespës. Çdo zhvillim në sektorin e turizmit duhet të marrë parasysh mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit natyror dhe kulturor. Duhet të kultivohet ndërgjegjja mjedisore si e banorëve ashtu edhe vizitorëve dhe të merren masa për mbrojtjen e monumenteve dhe burimeve natyrore të Bashkisë. Në të njëjtën kohë duhet të ruajë kushtet cilësore të banimit që disponon, nëpërmjet zhvillimit të qëndrueshëm të zonave të urbanizuara, krijimit të mjeteve të qëndrueshme të transportit publik, përmirësimit dhe krijimit të hapësirave të reja publike, sigurimit të aksesit për njerëzit me lëvizshmëri të reduktuar, parandalimit të reziqeve, përmirësimit të infrastrukturës shëndetësore, edukimit etj.


### Te dhena gjeografike per territorin e Bashkise Devoll

#### TE DHENA GJEOGRAFIKE PER TERRITORIN E BASHKISE DEVOLL

**Zona Gjeografike:** Devolli kufizohet në veri me Bashkinë Pustec, në perëndim me bashkitë Maliq dhe Korçë, në jug me bashkinë Kolonjë, ndërsa në lindje me Greqinë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Bilishtit.

**Popullsia:** Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia e re numëron 26.716 banorë, ndërsa sipas Regjistrimit Civil kjo bashki numëron një popullsi prej 42.388 vetësh. Bashkia e re ka një sipërfaqe prej 453.27 km<sup>2</sup>.

**Të dhëna të tjera:** Bashkia e Devollit është një zonë që dominohet nga popullsia fshatare, sigurimi i të ardhurave të cilës mbështeten në dy burime kryesore, bujqësia dhe blegtoaria nga njëra anë dhe remitancat nga emigracioni nga ana tjetër. Për shkak të pozicionit të saj kufitar me shtetin grek, një numër i konsiderueshëm banorësh kanë emigruar prej vitesh, duke gjeneruar të ardhura jo vetëm për veten e tyre por edhe për familjet e fshatrave.



#### NJËSITË ADMINISTRATIVE PËRBËRËSE

Emri i Njësisë	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
<b>Bilisht</b>	
<b>Qendër Bilisht</b>	Fshatrat; Bitinckë, Tren, Buzliqen, Vërnik, Vishocicë, Kuç, Poloskë, Kapshticë, Trestenik, Kurilë
<b>Hoçisht</b>	Fshatrat; Hoçisht, Grace, Baban, Stropan, Eçmenik, Përparimaj, Grapsh, Çipan, Borsh, Bradvicë
<b>Progër</b>	Fshatrat; Progër, Mançurisht, Cangonj, Pilur, Vranisht, Bickë, Rakickë, Shyec
<b>Miras</b>	Fshatrat; Miras, Vidohovë, Arrëz, Çetë, Qytezë, Sinicë, Nikolicë, Menkulas, Ponçarë, Braçanj, Koshnicë, Dobranj, Fitore, Ziçisht, Gjyres, Sul

<b>Qarku</b>	Korçë
<b>Qendra e Bashkisë</b>	Qyteti Bilisht
<b>Popullsia sipas Census 2011</b>	26,716
<b>Popullsia sipas Regjistrimit Civil</b>	42,388
<b>Sipërfaqja KM<sup>2</sup></b>	453.27

## **II. KUADRI LIGJOR**

- Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”;
- Ligji nr. 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
- Ligji nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Udhëzimi nr. 2 datë 06.02.2012 i Ministrisë së Financave “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar
- Ligje dhe akte nënligjore të tjera.

## **III. PARIMET THEMELORE TE FINANCEVE TE VETEQEVERISJES VENDORE**

1. Politikat kombëtare financiare garantojnë mjaftueshmërinë financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe bazohen në parimin e shumëllojshmërisë së burimeve të të ardhurave.
2. Funkcionet dhe kompetencat që u delegohen njësive të vetëqeverisjes vendore shoqërohen kurdoherë me mjetet e nevojshme financiare për realizimin e tyre.
3. Njësitë e vetëqeverisjes vendore financohen nga të ardhurat që sigurohen nga taksat, tarifat dhe të ardhurat e tjera vendore, nga fondet e transferuara nga qeverisja qendrore dhe fondet që u vijnë drejtpërdrejt atyre nga ndarja e taksave dhe tatimeve kombëtare, huamarrja vendore, donacione, si dhe burime të tjera, të parashikuara në ligj.
4. Njësive të vetëqeverisjes vendore u garantohet me ligj e drejta për krijimin e të ardhurave në mënyrë të pavarur.
5. Në rast se ndryshimet në politikën fiskale shoqërohen me ulje të niveleve, normave dhe bazës së taksave vendore apo të pjesës së të ardhurave të njësive të qeverisjes vendore nga taksat e ndara, Ministria e Financave është e detyruar të marrë masat për kompensimin e uljes, nëpërmjet rritjes së transfertave financiare dhe mundësive për huamarrjen vendore dhe/ose formave të tjera.
6. Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore harton, miraton, zbaton dhe administron çdo vit buxhetin e vet, padeficit, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon administrimin e zbatimin e sistemit buxhetor dhe ligjin për financat vendore.

#### **IV. PROCESI I HARTIMIT TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM, VJETOR DHE ROLI I TIJ**

Hartimi i PBA-së përbën një proces shumë të rëndësishëm për Bashkinë Devoll, pasi ky dokument siguron mekanizmat e nevojshme përmes të cilave, objektivat prioritare të identifikuar në Programin e Bashkisë Devoll dhe në dokumentat e tjerë strategjikë, të integrohen sa më mirë në procesin buxhetor. Objektivat e Programit Buxhetor Afatmësëm:

**a.** Përmiresimi i menaxhimit të shpenzimeve publike dhe rritja e efijencës së përdorimit të fondeve buxhetore, është objektivi parësor i PBA-së, në funksion të të cilit, angazhimi dhe mbështetja serioze e më përgjegjësi të lartë e të gjitha njësive pjesëmarrëse në PBA, mbetet thelbësore për ecurinë e suksesshme të këtij procesi.

**b.** Sigurimi i një shpërndarjeje dhe përdorimi efektiv dhe efijent i burimeve është objektivi nëpërmjet të cilit synohet të arrihet:

1. Një kuader i qëndrueshëm planifikimi afatmësëm, brenda të cilit të planifikohen buxhetet vjetore,
2. Forcimi i lidhjes mes programeve politike të Bashkisë dhe alokimit të burimeve.

#### **V. QELLIMET E PROGRAMIT BUXHETOR**

Programi Buxhetor Afatmësëm (PBA) është një instrument për prezantimin në mënyrë të integruar e disavjecare të parashikimit të të ardhurave dhe burimeve financiare publike dhe për planifikimin, manaxhimin dhe lëvrimin e shërbimeve publike. Si i tillë, ai është një komponent kryesor i planifikimit kombëtar dhe vendor.

Ashtu si edhe nivelet e tjera të qeverisjes, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVQV-të) janë përgjegjëse për menaxhimin e fondeve publike. Kjo përfshin mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore dhe menaxhimin e burimeve kombëtare që transferohen në bashki nga qeveria qendrore, disa prej të cilave kushtëzohen për shërbime specifike. Kjo do të thotë se kërkohet një instrument për të projektuar burimet e përgjithshme të disponueshme për shpenzimet vendore, duke përfshirë këtu: grantet, huatë, taksat e tarifat vendore dhe transferime nga qeveria qendrore (të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara).

Njësitë e vetëqeverisjes vendore ofrojnë shërbime publike vendore bazuar në kompetencat që u jep ligji. Si rrjedhojë, kjo kërkon një instrument për të lehtësuar dhe menaxhuar mënyrën e përdorimit të burimeve gjithsej, duke përfshirë vendimet për llojin e shpenzimeve (pagat dhe sigurimet; mallrat dhe shërbimet, interesat e borxhit, ripagimi i huave dhe kështu me radhë), si dhe vendimet strategjike se si do të alokohen burime midis llojeve të ndryshme të shërbimeve publike (sigurisë publike, arsimit, shëndetësisë, punëve publike dhe kështu me radhë).

Procesi i PBA-së, prezanton në mënyrë të integruar informacionin mbi parashikimet e të ardhurave dhe burimeve gjithsej dhe përcakton objektivat përse do të shpenzohen ato, kostot e nevojshme dhe llojin e secilit shërbim që do të ofrohet. Ndër të tjera, kjo përfshin lidhjen e

qëllimeve dhe objektivave të bashkisë me qëllime strategjike të përcaktuara në strategjitë lokale dhe kombëtare. Procesi i PBA-së, disiplinon maturinë financiare vendore duke planifikuar shpenzimet publike brenda një kuadri realist financiar vendor. Në të njëjtën kohë, ai synon të garantojë që shërbimet publike vendore plotësojnë nevojat në rritje të banorëve duke treguar se si shpenzimet publike për prioritetet strategjike të zhvillimit të njësisë vendore përkthehen në vendime konkrete për ofrimin e shërbimeve publike vendore, me lidhje të qarta mes politikave vendore dhe prioriteteve vjetore të shpenzimeve .

Në procesin e PBA-së planifikimi dhe buxhetimi vendor afatgjatë e ndihmon njësinë vendore të planifikojë sesi shërbimet publike do të evoluojnë me kalimin e kohës, duke përcaktuar kërkesat disavjeçare të shpenzimeve në fusha të ndryshme të ofrimit të shërbimeve në përputhje jo vetëm me ndryshimet e parashikuara në demografinë, por edhe në përputhje me ndryshimin e nevojave të banorëve të bashkisë. Kombinimi i këtij informacioni me parashikimin për nevojat dhe burimet në dispozicion në të ardhmen, u mundëson njësisë vendore që të planifikojnë shërbime publike në mënyrë të qëndrueshme, si dhe të zhvillojnë një kuadër afatmesëm të burimeve si bazë për planifikimin afatmesëm të shpenzimeve.

Gjithashtu, procesi i PBA-së siguron një kornizë për planifikimin e investimeve publike sipas programeve buxhetore duke përfshirë edhe kërkesat për shpenzimeve korente. Kjo siguron një bazë të fortë mbi të cilën mund të merren vendimet për investime, të lidhura me planet strategjike dhe planet afatmesme për zhvillimin e shërbimeve të ndryshme publike që njësisia vendore ofron për banorët.

Në mënyrë të përmbledhur Programi Buxhetor Afatmesëm përfshin këto procese:

- prezanton informacionin mbi të ardhurat dhe burimet e disponueshme të bashkisë;
- përkthen vizionin strategjik të NJVQV-së në plane praktike për ofrimin e shërbimeve gjatë një periudhë disavjeçare;
- shpërndan burimet sipas fushave të veçanta të ofrimit të shërbimeve publike,
- përcakton treguesit e performancës në secilën fushë të ofrimit të shërbimeve;
- llogarit kërkesat vjetore të shpenzimeve (korente dhe për investime) në përputhje me objektivat dhe treguesit e performancës për një periudhë disavjeçare; dhe
- përcakton treguesit vjetorë të performancës në përputhje me parashikimet për burimet në dispozicion përgjatë një periudhe disavjeçare.

Në qendër të PBA-së janë dy procese planifikimi dhe buxhetimi që NJVQV-të ndërmarrin për të planifikuar treguesit e performancës dhe shpenzimet afatmesme, si dhe propozimet për buxhetet vjetore:

- Përcaktimi i Qëllimeve dhe Objektivave të Programit (nëpërmjet Rishikimit të Politikës së Programit);
- Planifikimi i Shpenzimeve të Programit (në funksion të ofrimit të shërbimeve).

## **VI. BUXHETI 2023**

Ky dokument synon të informojë Këshillin Bashkiak Devoll dhe publikun e gjërë lidhur me planet e shpenzimeve të Bashkisë, të cilat do të çojnë në arritjen e objektivave strategjike të programit të Kryetarit të Bashkisë Devoll.

Dokumenti synon ti japë mundësinë Këshillit Bashkiak, si organ vendimmarrës, për të zhvilluar një kuader të qartë burimesh që do të shërbejë si bazë për planifikimin e shpenzimeve korrente dhe kapitale të Bashkisë.

Ky program iu shërben gjithashtu Njësive Shpenzuese pasi mundëson përcaktimin në mënyrë të qartë prej tyre të politikave dhe programeve për çdo aktivitet, për të përcaktuar kostot dhe prioritetet e tyre brenda kontekstit të burimeve të disponueshme, në mënyrë që burimet financiare të mund të alokohen tek programet prioritare në periudhën afatmesme.

Ky proces synon parashikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve aktuale, si një mjet që përkthen qëllimet dhe objektivat strategjike në synime financiare, duke prezantuar politikat fiskale dhe financiare të Bashkisë Devoll.

Gjithashtu, parashikimi i të ardhurave e shpenzimeve dhe përcaktimi i fondeve afatmesme në dispozicion për investime, krijojnë mundësinë për vlerësimin e aftësive kredimarrëse të Bashkisë Devoll, dhe lejon në këtë mënyrë përdorimin e një instrumenti alternativ për rritjen e investimeve kapitale, të financuar nga burime të jashtme dhe të brendshme, në funksion të përmirësimit të infrastrukturës dhe shërbimeve në dobi të komunitetit.

## **VII. PRIORITETET PËR VITIN 2023**


Objektivi themelor i buxhetit do të jetë përmirësimi i procesit të planifikimit, hartimit dhe zbatimit të buxhetit si dhe kthimi i Bashkisë Devoll në një zonë më të mirë për të jetuar. Ky objektivi do të realizohet përmes mbrojtjes së mjedisit dhe reduktimit të ndotjes, garantimit të cilësisë në tregjet publike dhe rritjes së sigurisë në rrugë e në objektet shkollorë; përmirësimit të kushteve në çerdhe, kopshte e shkolla dhe ofrimin të shërbimeve sociale cilësore; meremetimit të infrastrukturës rrugore, përmirësimit të transportit publik, fuqizimit të rinisë dhe shtresave të tjera, rigjallërimit të jetës kulturore dhe masivizimit të sporteve; rritjes së punësimit dhe zhvillimit të ekonomisë rurale.

Shtyllat kryesore në të cilat është mbështetur hartimi i buxhetit do të jenë pikërisht këto synime:

- Ofrimi i shërbimeve cilësore;
- Përmirësimi i infrastrukturës arsimore;
- Përmirësimi i infrastrukturës dhe transportit;
- Garantimi i pastërtisë dhe reduktimi i ndotjes;
- Rigjallërimi i jetës kulturore dhe sportive;
- Ndërtimi i veprave publike.

## VIII. BURIMET FINANCIARE

Ne total buxheti per vitin 2023 shkon ne vleren 532.9 ml leke. Nga keto 43% mbulohet nga transferta e pakushtezuar, 21% nga transferta specifike, dhe 36 % nga te ardhurat e parshikuara per vitin 2022.



### ❖ Transferta e pakushtezuar

Transferta e pakushtezuar nga Buxheti i Shtetit u jepet njësive të vetëqeverisjes vendore për financimin e ushtrimit të funksioneve dhe kompetencave të tyre të përcaktuara me ligj. Shuma totale vjetore e fondeve për tu ndarë ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore nëpërmjet transfertës së pakushtezuar, në një vit të dhënë buxhetor, është jo më pak se 1 % produktit të brendshëm bruto, të parashikuar në raportin për vlerësimet dhe parashikimet makroekonomike të miratuar nga Keshilli i Ministrave, sipas nenit 23, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar. Në çdo rast, transferta e pakushtezuar nuk mund të jetë më e vogël se shumata totale e ndarë në vitin e mëparshëm buxhetor.

Ndarja e transfertës së pakushtezuar për bashkitë, bazohet në:

- popullsinë rezidente, e cila është produkt i Census-it më të fundit, të korrigjuar me popullsinë sipas Regjistrit të Gjendjes Civile, sipas një koeficienti të publikuar në anekset e ligjit të buxhetit
- dëndësia e popullsisë, që reflekton diferencat në kostot e ofrimit të shërbimeve ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore. Sipas këtij kriteri shpërndahen deri në 15 % e transfertës
- numri i nxënësve në arsimin parauniversitar.




Krahasimisht me vitet e kaluara transfertat e pakushtezuar ka pesuar rritje te konsiderueshme per vitin 2023. Në vitin 2023 për Transferten e Pakushtëzuar kemi një rritje me 15.74 % krahasuar me vitin 2022 ose 31 milion lekë më tepër se viti 2022.

Në 000/lekë

Viti	Shuma e transfertës	Rritja
2019	184,579	0
2020	189,509	4,930
2021	193,299	3,790
2022	199,230	5,931
2023	230,606	31,376

Në grafik paraqitet shpërndarja e grantit për 5 vite dhe vlerat përkatëse.



### ❖ **Transfertat specifike**


Transfertat specifike financojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore për:

**a)** financimin e funksioneve të reja të transferuara te njësitë e vetëqeverisjes vendore, për një periudhë tranzitore deri në përcaktimin e një skeme ekuivalente dhe të qëndrueshme financimi;

**b)** financimin e shërbimeve në raste të emergjencave apo situatave të ngjashme me interes të vitit buxhetor rezulton me fonde të papërdorura nga transfertat specifike për funksionin për të kryer funksionet e deleguara si më poshte:

1. Arsimi parashkollor, edukatore dhe punonjës në qendrat kulturore të fëmijëve.
2. Arsimi parauniversitar, punonjës të shërbimeve mbështetëse në arsimi i mesëm.
3. Mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi (P.M.N.Z.Sh.).
4. Administrimi i pyjeve.
5. Administrimi i rrugëve rurale.
6. Administrimi i ujitjes dhe kullimi.
7. Emergjencia Civile .

Grafiku mëposhtë jep tendencën e transfertës specifike për funksionet e transferuara.



Për kryerjen e këtyre shërbimeve Qeverisja Qëndrore ka përcaktuar dhe numrin e punonjësve për secilin sektor.

Nr.	Programi	Emërtimi i njësive shpenzuese	Nr i punonjësve
1	9120	Arsimi parashkollor	69
2	9230	Arsimi parauniversitar	4
3	3280	Emergjencat civile	14
4	4260	Administrimi i pyjeve	6
5	4240	Ujitja e kullimi	4
<b>TOTALI</b>			<b>97</b>

Për secilin funksion është bërë shpërndarja dhe përllogaritja sesi do të përdoren këto fonde. Kjo është rekomanduar nga Qeverisja Qëndrore dhe në kryejmë specifikimet përkatëse për shpenzimet operative të cilat përcaktohen duke marrë për bazë shpenzimet e vitit të kaluar. Shpërndarja e fondeve është realizuar sipas tabelës së mëposhtme dhe programeve përkatës:

#### ❖ Te Ardhurat

Te ardhurat kanë një trend rritës për realizimi për 2022 pritet të jetë 81%. Taksat lokale do të realizohen në masën 87%, Taksat e ndara në masën 119% për shkak të realizimit të zerit së Takses mbi te ardhurat Personale, tarifatat do të realizohen në masën 76.8% për shkak të levizjes së popullsisë, dhe te ardhurat e tjera do të realizohen në masën 69%. Krahasuar me vitin 2022 viti 2023 ka rritje të disa prej taksave dhe tarifave. Në total do të kemi 9.312 mijë leke më tepër. Kjo rritje është parashikuar në zëra si Taksa e ndërtesës e cila është rritur për shkak të planifikimit mbi gjendjen faktike të numrit të popullsisë. Rritje do të ketë edhe taksa e ndikimit në infrastrukturë, me një rritje 50% të planit të vitit 2022 dhe 7% më tepër nga realizimi faktik i vitit 2022. Rritje të konsiderueshme do të ketë tarifa e shërbimit të ujitjes dhe kullimit për shkak të aplikimit të tarifës së mirëmbajtjes së kanaleve ujëtare dhe kulluese sqaruar në paketën fiskale. Te ardhurat e tjera janë planifikuar me ulje për shkak të ndërgjegjesimit të taksapaguesve.

Me poshtë jepet tabela e planifikimit të te ardhurave të përmbledhura për periudhën 2020-2025.

Te ardhurat	Fakt 2020	Fakt 2021	Plan 2022	I pritshmi 2022	Parashikim 2023	Parashikim 2024	Parashikim 2025
Taksat Lokale	33,364	38,042	53,510	46,610	60,270	60,713	58,337
Taksat e ndara	11,512	20,400	12,900	15,400	17,050	17,173	17,378
Tarifatat	48,904	42,546	75,101	57,704	81,374	83,926	90,533
Te ardhura të tjera	28,199	32,890	42,933	29,690	35,062	33,598	31,600
<b>Totali</b>	<b>121,979</b>	<b>133,878</b>	<b>184,444</b>	<b>149,404</b>	<b>193,756</b>	<b>195,410</b>	<b>197,848</b>

Tabela e realizimit te dy viteve dhe planifikimit per 3 vitet e ardhshme .

		2019	2020	2021	2021	2022	2023	2024
<b>BURIMET BUXHETORE</b>		<b>Fakti</b>	<b>Fakti</b>	<b>Buxh. Fillestar</b>	<b>Pritshmi</b>	<b>Plani</b>	<b>Plani</b>	<b>Plani</b>
<b>A</b>	<b>Të Ardhura nga Burimet e Veta</b>	121,979	133,878	184,444	149,404	193,756	195,410	197,848
<b>A.1</b>	<b>Të Ardhura nga Taksat Lokale</b>	33,364	38,042	53,510	46,610	60,270	60,713	58,337
<b>A.1.1</b>	<b>Taksa vendore mbi biznesin e vogël</b>	496	382	300	300	60	60	60
<b>A.1.2</b>	<b>Taksa mbi pasurinë e paluajtshme</b>	27,183	25,496	41,150	30,450	43,150	43,493	44,405
A.1.2.1	Taksa mbi ndërtesën	11,484	10,845	14,150	13,450	16,150	16,343	17,160
A.1.2.2	Taksa mbi tokën bujqësore	12,909	12,172	24,000	14,000	24,000	24,000	24,000
A.1.2.3	Taksa mbi truallin	2,790	2,479	3,000	3,000	3,000	3,150	3,245
A.1.2.4	Taksa mbi transaksionet e pasurisë	-	-	-	-	-	-	-
<b>A.1.3</b>	<b>Taksa vendore në shërbimin hotelier</b>	27	-	60	60	60	60	60
<b>A.1.4</b>	<b>Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja</b>	2,010	8,726	10,000	14,000	15,000	15,000	11,670
<b>A.1.5</b>	<b>Taksa e tabelës</b>	1,885	950	2,000	1,800	2,000	2,100	2,142
<b>A.1.6</b>	<b>Taksa vendore mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimi, testament dhe llot. Vend.</b>	-	-	-	-	-	-	-
<b>A.1.7</b>	<b>Taksa e përkohëshme</b>	1,763	2,488	-	-	-	-	-
<b>A.1.8</b>	<b>Taksa e përkohëshme 1</b>	-	-	-	-	-	-	-
<b>A.1.9</b>	<b>Taksa e përkohëshme 2</b>	-	-	-	-	-	-	-
<b>A.2</b>	<b>Të Ardhurat nga Taksat e Ndara</b>	11,512	20,400	12,900	15,400	17,050	17,173	17,378
<b>A.2.1</b>	<b>Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë / pasuritë e paluajtshme</b>	980	114	150	150	300	198	208
<b>A.2.2</b>	<b>Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura</b>	10,282	9,958	10,000	10,000	11,000	11,000	11,000
<b>A.2.3</b>	<b>Taksa e rentës minerare</b>	-	-	-	-	-	-	-
<b>A.2.4</b>	<b>Taksa mbi të ardhurat personale</b>	-	7,470	2,500	5,000	5,000	5,000	5,000
<b>A.2.5</b>	<b>Taksa të tjera</b>	250	2,858	250	250	750	975	1,170
<b>A.3</b>	<b>Të Ardhurat nga Tarifat Vendore</b>	48,904	42,546	75,101	57,704	81,374	83,926	90,533
<b>A.3.1</b>	<b>Tarifa me menaxhimin te mbetjeve</b>	24,711	27,007	41,632	30,000	41,632	41,644	41,690

A.3.1.1	Tarifa e pastrimit për familjet	11,000	12,500	18,150	13,000	25,241	25,000	25,000
A.3.1.2	Tarifa e pastrimit për institucionet	700	760	1,040	1,000	1,070	1,144	1,190
A.3.1.3	Tarifa e pastrimit për biznesin	13,011	13,747	22,442	16,000	15,321	15,500	15,500
<b>A.3.2</b>	<b>Tarifa për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve</b>	-	-	-	-	-	-	-
<b>A.3.3</b>	<b>Tarifa për ndriçimin publik</b>	10,892	10,628	18,641	13,990	18,500	18,545	19,000
A.3.3.1	Tarifa për ndriçimin publik nga familjet	5,000	4,840	8,341	6,300	11,545	11,545	12,000
A.3.3.2	Tarifa për ndriçimin publik nga institucionet	-	160	190	190	200	200	200
A.3.3.3	Tarifa për ndriçimin publik nga biznesi	5,892	5,628	10,110	7,500	6,755	6,800	6,800
<b>A.3.4</b>	<b>Tarifa për gjelbërimin</b>	241	515	1,257	1,153	1,440	1,449	1,458
A.3.4.1	Tarifa për gjelbërimin nga familjet	241	190	357	357	600	412	421
A.3.4.2	Tarifa për gjelbërimin nga Institucionet	-	36	46	46	57	51	51
A.3.4.3	Tarifa për gjelbërimin nga bizneset	-	289	854	750	783	986	986
<b>A.3.5</b>	<b>Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë</b>	8,523	2,711	4,111	3,901	3,560	5,508	11,585
A.3.5.1	Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë	-	-	-	-	-	-	-
A.3.5.2	Tarifa për dhënie e licensave, lejeve e autorizimeve	418	434	790	600	790	838	855
A.3.5.3	Tarifa të kontrollit të zhvillimit të territorit	-	-	-	-	-	-	-
A.3.5.4	Tarifa për vulosje veterinarie të bagëtive të therura	-	-	150	150	-	158	158
A.3.5.5	Tarifa e licensimit të veprimtarive të transportit	-	-	-	-	-	-	-
A.3.5.6	Tarifa e parkimit për mjetet e licensuara dhe vendparkime publike	509	572	870	850	870	1,005	1,025
A.3.5.7	Tarifa për dhënie license për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj	6,600	800	1,000	1,000	600	2,000	8,000
A.3.5.8	Tarifa për pyejt dhe kullotat	-	-	-	-	-	-	-
A.3.5.9	Tarifa për shërbimet shtesë nga zjarrëfiksja	-	167	200	200	200	210	210
A.3.5.10	Tarifa për zënien dhe përdorimin e hapsirës publike dhe fasadave	696	598	690	690	650	797	837
A.3.5.11	Tarifa për trajtimin e mbetjeve inerte në landfille	-	-	-	-	-	-	-
A.3.5.12	Tarifa për linjat ajrore dhe nëntoksore (Telefoni, Energji, TV Kabllor, Internet)	300	140	411	411	450	500	500
A.3.5.13	Tarifa nga dokumentat për tender, ankand etj	-	-	-	-	-	-	-
<b>A.3.6</b>	<b>Tarifa të institucioneve të arsimit, kulturës, sportit etj</b>	456	733	960	960	960	1,000	1,000

A.3.6.1	Bibloteka	-	-	-	-	-	-	-
A.3.6.2	Muzeumet	-	-	-	-	-	-	-
A.3.6.3	Teatri	-	-	-	-	-	-	-
A.3.6.4	Qendra kulturore e fëmijëve	-	-	-	-	-	-	-
A.3.6.5	Pallati i sportit	-	-	-	-	-	-	-
A.3.6.6	Qendra Komunitare	-	-	-	-	-	-	-
A.3.6.7	Mensa (Konviktet)	-	-	-	-	-	-	-
A.3.6.8	Kopshtet	-	-	-	-	-	-	-
A.3.6.9	Çerdhet	456	733	960	960	960	1,000	1,000
A.3.7	Tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizime	-	-	-	-	-	-	-
A.3.8	Tarifa për shërbimin e ujitjes dhe kullimit	231	430	1,500	1,200	8,780	8,780	8,800
A.3.9	Tarifa e përkohëshme	-	-	-	-	-	-	-
A.3.10	Tarifa të tjera	3,850	522	7,000	6,500	6,502	7,000	7,000
A.4	Të Ardhurat e Tjera	28,199	32,890	42,933	29,690	35,062	33,598	31,600
A.4.1	Qeraja nga asetet në pronësi të bashkisë	3,399	1,734	2,390	2,390	3,072	2,850	2,850
A.4.2	Kthimi nga investimet kapitale	-	-	-	-	-	-	-
A.4.3	Fitimi nga ndërmarrjet publike në varësi të Bashkisë	-	-	-	-	-	-	-
A.4.4	Kthimi nga partneriteti publik privat	-	-	-	-	-	-	-
A.4.5	Tërheqje e të ardhura krijuar nga shërbimet	-	-	-	-	-	-	-
A.4.6	Shitja e mallrave dhe shërbimeve	-	-	-	-	-	-	-
A.4.7	Kundravajtjet administrative (Gjobat)	53	132	2,400	2,300	1,600	1,600	1,600
A.4.8	Sekuestrime dhe Zhdëmtime	-	-	-	-	-	-	-
A.4.9	Kuotat e anëtarësisë së bashkive	-	-	-	-	-	-	-
A.4.10	Trasferta dhe ndihma nga njësitë e tjera vendore	-	-	-	-	-	-	-
A.4.11	Grante nga ndihma ndërkombëtare	7,566	15,774	-	-	-	-	-
A.4.12	Shitja e aseteve financiare	-	-	-	-	-	-	-
A.4.13	Shitja e aseteve fikse të prekshme / paprekshme	-	-	-	-	-	-	-
A.4.14	Të tjera	17,181	15,250	38,143	25,000	30,390	29,148	27,150
B	Transferta nga Buxheti Qendror	284,786	300,972	328,766	328,766	339,166	331,098	345,725

<b>B.1</b>	<b>Transferta e Pakushtëzuar</b>	189,509	193,299	199,230	199,230	230,606	225,877	240,474
<b>B.2</b>	<b>Transferta e Kushtëzuar</b>	-	-	25,357	25,357	-	-	-
<b>B.2.1</b>	<b>Për funksionet e deleguara</b>	-	-	-	-	-	-	-
<b>B.2.2</b>	<b>Për projekte të veçanta (FZHR dhe të tjera)</b>	-	-	25,357	25,357	-	-	-
<b>B.3</b>	<b>Trasferta e Pakushtëzuar Sektoriale</b>	95,277	107,673	104,179	104,179	108,560	105,221	105,251
<b>C</b>	<b>Huamarrja</b>	-	-	-	-	-	-	-
<b>C.1</b>	<b>Huamarrja Afatshkurtër</b>	-	-	-	-	-	-	-
<b>C.2</b>	<b>Huamarrja Afatgjatë</b>	-	-	-	-	-	-	-
<b>D</b>	<b>Trashëgimi nga Viti i Shkuar</b>	148,420	133,100	135,073	135,073	-	-	-
<b>D.1</b>	<b>Trashëgimi Pa Destinacion</b>	-	-	-	-	-	-	-
<b>D.2</b>	<b>Trashëgimi Me Destinacion</b>	148,420	133,100	135,073	135,073	-	-	-
<b>TOTALI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË</b>		<b>555,185</b>	<b>567,950</b>	<b>648,283</b>	<b>613,243</b>	<b>532,922</b>	<b>526,508</b>	<b>543,573</b>

## ❖ **SHPENZIMET E BASHKISË DEVOLL PËR VITIN 2023**

*Për buxhetin e vitit 2023 është parashikuar që shpërndarja e fondeve të bëhet në bazë të 15 programeve duke reflektuar dhe sugjerimet e Ministrisë së Financave dhe në përputhje me formatet e reja të Instrumentit të Planifikimit Financiar.*

### **STRUKTURA**

*Per vitin 2023 eshte parashikuar nje rritje punonjesish prej 16 punonjes te rinj krahasuar me vitin 2022 qe kishim 379 dhe pakesohen 6 punonjes perkatesisht :Ne total truktura per vitin 2023 shkon 395 punonjes e shperndare sipas programeve si me poshte:*

**TABELA E NUMRIT TE PUNONJESVE SIPAS NJESIVE SHPENEZUESE PER BUXHETIN E VITIT 2023**

PROG.	PERSHKRIMI I PROGRAMIT	NUMRI I PUNONJESVE VITI 2022	NUMRI I PUNONJESVE VITI 2023	BUXHETI VENDOR	TE TRANSFERUAR
`011	Administrata dhe çeshtjet financiare	64	66	66	0
`031	Sherbimet e Policise Vendore	11	13	13	0
`032	Mbrojtja ndaj zjarrit & Emergjencat Civile	17	17	3	14
`042	Buqesia, Pyje , Peshkimi dhe Gjuetia	36	36	26	10
`045	Transporti	21	23	23	0
`051	Menaxhimi I mbetjeve	0	0	0	0
`061	Zhvillimi I strehimit	17	12	12	0
`062	Sherbime publike	64	65	65	0
`081	Sherbime kreative dhe Sportiv	0	13	13	0
`082	Sherbime Kulturore	19	10	10	0
`091	Arsimi baze dhe parashkollor	112	106	37	69
`092	Arsimi Mesem	4	4	0	4
`0104	Familje dhe Femije	14	30	30	0
	<b>TOTALI</b>	<b>379</b>	<b>395</b>	<b>298</b>	<b>97</b>

- **Programi 011** Organet ekzekutive dhe legjislative, çështjet financiare dhe fiskale, çështjet e brëndshme .

Ky program përfshin: planifikimin, menaxhimin dhe administrimin, çështjet financiare dhe fiskale si dhe shërbime të përgjithshme publike. Qëllimi i këtij programi është menaxhimi i financave dhe burimeve njerëzore në përputhje me kuadrin ligjor dhe prokurimin publik në funksion të mirëqeverisjes së Bashkisë Devoll, sipas standarteve kombetare ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Per vetqeverisjen Vendore”



**OBJEKTIVAT E PROGRAMIT JANË:**

Objektivi 1: Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore;

Objektivi 2: Përmirësimi i menaxhimit të burimeve financiare;

Objektivi 3: Rritja e efikasitetit të zbatimit të procedurave të prokurimit publik.

Objektivi 4: Rritja e nivelit të vendimarrjes nga ana e Këshillit Bashkiak.

Në këtë program janë parashikuar shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore për 66 punonjës. Në nivel shpenzimesh jemi në të njëjtin nivel me vitin 2022.

NR.	PERSHKRIMI	Plani 2023
1.	Paga	43,271,795
2.	Sigurime	8,167,395
3.	<i>Shpenzime operative</i>	16,126,600
4.	<i>Transferta ne institucione te tjera</i>	600,000
5.	<i>Transferta ne familje</i>	0
6.	<i>Projekte</i>	0
7.	<i>Investime</i>	7,850,000
	<b>TOTALI</b>	<b>76,015,790</b>

Tabela e mëposhtme ka të përmbledhur zerat e shpenzimeve që realizohen për vitin 2023.

NR.	PERSHKRIMI	Plani 2023
1.	<i>Shpenzime udhëtimi</i>	400,000
2.	<i>Vendime gjyqësore për punonjësit</i>	-
3.	Këshillit të qarkut 1%	1,000,000
4.	<i>Fondi rezerve</i>	500,000
5.	Ujesjelles sha, agjent tatimor	600,000
6.	Qera trualli	560,000
7.	Shperblim I keshilltareve	2,545,200
8.	Shperblim I Kryepleq	3,854,400
9.	Kancelari	600,000
10.	Tonera	800,000
11.	Materiale për funks. e paisjeve të zyrës (PC)	600,000
12.	Sherbime mirembajtje paisje kompjuterike	300,000
13.	Kuti arkive	604,000
14.	Materiale për arkiven	150,000

15.	Energji Elektrike	1,200,000
16.	Uje	300,000
17.	Sherbim interneti	600,000
18.	Sherbime postare	1,000,000
19.	Mirembajtje Ëeb	120,000
20.	Ekspert te jashtem	100,000
21.	Buxheti per Keshillin Bashkiak	242,000
22.	Fushata ndergjegjesimi per mbrojtjen e mjedisit	81,000
23.	Leje Mjedisore	150,000
24.	Lyerje institucionet administrative	420,000
<b>SHPENZIME TOTALE</b>		<b>16,726,600</b>
1.	Blerje Automjetesh per Administraten	1,500,000
2.	Shpronesime	5,000,000
3.	Blerje PC & Printera	1,350,000
<b>INVESTIME TOTALE</b>		<b>7,850,000</b>

- **Programi 031** Ky program përfshin Shërbimet Policore .

Objektivi i këtij programi është përmirësim i sigurisë dhe ruajtjen e rendit publik.

Për ndjekjen dhe kryerjen e shpenzimeve është Policia Bashkiake si dhe drejtuesi i programit.

NR.	PERSHKRIMI	Plani 2023
1.	Paga	7,192,800
2.	Sigurime	1,201,198
3.	<i>Shpenzime operative</i>	1,595,000
4.	<i>Transferta ne institucione te tjera</i>	0
5.	<i>Transferta ne familje</i>	0
6.	<i>Projekte</i>	0
7.	<i>Investime</i>	0
<b>TOTALI</b>		<b>9,988,998</b>

Më poshtë paraqitet në mënyrë analitike shpenzimet që parashikohen për vitin 2023.

**Sherbimet e Policise Vendore 3140**

NR.	PERSHKRIMI	Plani 2023
1.	Paga	7,192,800
2.	Sigurime	1,201,198
	<b>PAGA&amp;SIGURIME</b>	<b>8,393,998</b>
3.	Karburant	645,000
4.	Uniforma	450,000
5.	Materiale pune	220,000
6.	Sherbime mirembajtje automjeti	200,000
7.	Kolaudim siguracion	80,000
	<b>SHPENZIME TOTALE</b>	<b>1,595,000</b>

- **Programi 032** Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri.

Qëllimi i programit është ofrimi i shërbimit për mbrojtjen e jetës dhe pronës nga zjarri dhe fatkeqsitë natyrore sipas standarteve kombëtare për mbrojtje nga zjarri dhe shpëtimi.

**Objektivat e këtij programi janë:**

**OBJEKTIVI 1:** VLERËSIMI I PIKAVE TË RREZIKUT SI REZULTAT I PËRMBYTJEVE, RRËSHQITJEVE TË DHEUT, BLOKIMI I AKSEVE RRUGORE NGA DËBORA, I SITUATËS SË RËNDUAR NGA ZJARRE MASSIVE;

**OBJEKTIVI 2:** INSPEKTIM I SUBJEKTEVE TREGTARE PËR MASAT E NDËRMARRA PËR MBROJTJEN NGA ZJARRI;

**OBJEKTIVI 3:** VLERËSIM I DËMEVE DHE KOMPENSIM PËR INDIVIDE NË RAST EMERGJENCASH;

**OBJEKTIVI 4:** PLOTËSIMI I STACIONIT ZJARRFIKËS ME PAJISJE PËR MBROJTJEN DHE SHUARJEN E ZJARRIT DHE MIRËMBATJE E STACIONIT.

Në zbatim të ligjit nr.45/2019 “Për mbrojtjen Civile” neni 65 përcakton qartë buxhetin e Bashkive në lidhje me fondin e Emergjencave Civile. Sipas përcaktimeve të ligjit citohet se ... *Bashkitë, për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, si dhe kryerjen e detyrave në zbatim të këtij ligji, mbështeten në parashikimin minimal prej 4 për qind të totalit të buxhetit vjetor të tyre, të cilat sigurohen nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit.*

2. *Bashkitë mund të planifikojnë fonde të tjera shitesë nga burimet financiare, si më poshtë: a) nga të ardhurat e veta vendore; b) nga fondet që u vijnë drejtpërdrejt nga ndarja e taksave dhe tatimeve kombëtare, huamarrja vendore, donacionet; c) si dhe burime të tjera të parashikuara në ligj.*

3. *Procedurat dhe kriteret e ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.*

Brenda mundësive tona financiare ne kemi parashikuar një fond për emergjenca civile në vlerën 1.000.000 lekë .Për sa i takon Stacionit te P.M.N.Z.SH këtë vit, si zë i shtuar është parashikuar sigurimi i jetës së punonjësve të zjarrfikëses në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.382 datë 13.05.2020 “Për sigurimin e jetës së punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi” I cili na ngarkon me përgjegjësi mbi mbarvajtjen e shërbimit.

NR.	PERSHKRIMI	Plani 2023
1.	Paga	15,356,400
2.	Sigurime	2,564,519
3.	<i>Shpenzime operative</i>	3,006,700
4.	<i>Transferta ne institucione te tjera</i>	0
5.	<i>Transferta ne familje</i>	1,000,000
6.	<i>Projekte</i>	0
7.	<i>Investime</i>	0
	<b>TOTALI</b>	<b>21,927,619</b>

Shpenzimet për programin e Mbrojtjes nga Zjarri paraqiten si më poshtë:

NR.	PERSHKRIMI	Plani 2023
1	Paga	13,155,600
2	Sigurime	2,196,985
	<b><i>PAGA&amp;SIGURIME</i></b>	<b><i>15,352,585</i></b>
3	Karburant	1,296,300
4	Uniforma	420,000
5	Sherbime per stacionin e MZSH	264,000
6	Siguracione dhe taksa	80,000
7	Sigurimi I jetes per punonjesit	350,000
8	Uje	150,000
9	Energji Elektrike	240,000
	<b><i>SHPENZIME TOTALE</i></b>	<b><i>2,800,300</i></b>
NR.	PERSHKRIMI	Plani 2023
1	Paga	2,200,800
2	Sigurime	367,534
	<b><i>PAGA&amp;SIGURIME</i></b>	<b><i>2,568,334</i></b>
3	Fondi i Emergences Civile	1,000,000
4	Karburant	206,400
	<b><i>SHPENZIME TOTALE</i></b>	<b><i>1,206,400</i></b>

Për ndjekjen dhe kryerjen e shpenzimeve është Sektori i Emergjencave Civile , P.M.N.Z.SH si dhe drejtuesi i programit.

- **Programi 042** Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia.

Qëllimi i këtij programi është mbrojtja e jetës së kafshëve, ruajtja e sigurisë ushqimore dhe përmiresimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit sipas standarteve kombëtare, VKM nr.1108 datë 30.12.2015 “Për transferimin nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit rural dhe Administrimit të ujrave të Bashkisë, të infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit”, Ligjit, Nr. 24/2017. Për Administrimin e Ujitjes dhe Kullimit, gjithashtu ka për qëllim ruajtjen dhe shtimi i sipërfaqeve pyjore dhe kullotave, sipas standarteve kombëtare për pyjet dhe kullotat referuar ligjit të pyjeve nr. 9385 datë 04.05.2005 i ndryshuar, ligjit me nr 9693 datë 19.03.2007 “për Fondin Kullosor “ i ndryshuar.

**OBJEKTIVAT E KËTIJ PROGRAMI JANË:**

**OBJEKTIVI 1:** MIRËMBAJTJA E 60% E KANALEVE UJITËSE DHE KULLUESE NË BASHKINË DEVOLL;

**OBJEKTIVI 2:** MIRËMBAJTJA E 11 REZERVUARVE;

**OBJEKTIVI 3:** KRYERJA E INSPEKTIMEVE PËR 100% TË SKEMAVE FUNKSIONALE UJITËSE E KULLUESE;

**OBJEKTIVI 4:** RRITJA E SIGURISË SË USHQIMEVE NËPËRMJET NJË PLANI KONTROLLI NË TË GJITHË TERRITORIN E BASHKISË DEVOLL;

**OBJEKTIVI 5 :** KRYERJA E KONTROLLEVE MBI GJËNDJEN E 20% TË FONDIT PYJOR E KULLOSOR 14,000 HA;

**OBJEKTIVI 6:** VLERËSIMI I PIKAVE TË RREZIKUT NË PYJE E KULLOTA;

**OBJEKTIVI 7:** VLERËSIM I INFRASTRUKTURËS UJËPIRËSE TË BAGËTIVE NË PYJE E KULLOTA;

**OBJEKTIVI 8:** RIVLERËSIM DHE HARTIMI I PLANEVE TË MENAXHIMIT 10 VJEÇARE KU PËRFSHIHEN PYJET

,KULLOTAT ,BIMËT MEDICINALE DHE FAUNA E EGËR.

Për këtë vit transferta specifike për pyjet dhe kullimin për vitin 2023 është në vlerën 17,507,000 lekë dhe krahasuar me vitin 2022 ka një shtesë fondi prej 498 mijë lekë.

NR.	PERSHKRIMI	Plani 2023
1.	Paga	19,807,200
2.	Sigurime	3,307,801
3.	<i>Shpenzime operative</i>	11,383,793
4.	<i>Investime</i>	526,000
	<b>TOTALI</b>	<b>35,024,794</b>

Tabela e mëposhtme ka të përmbledhur zerat e shpenzimeve që realizohen për vitin 2023.

### Inspektimi I ushqimit dhe mbrojtja e konsumatoreve 4220

NR.	PERSHKRIMI	Plani 2023
1	Paga	6,417,600
2	Sigurime	1,071,739
	<b>PAGA&amp;SIGURIME</b>	<b>7,489,339</b>
3	Materiale	36,000
	<b>SHPENZIME TOTALE</b>	<b>36,000</b>

### Menaxhimi I infrastruktures ujitjes dhe kullimit 4240

NR.	PERSHKRIMI	Plani 2023
1	Paga	6,453,600
2	Sigurime	1,077,751
	<b>PAGA&amp;SIGURIME</b>	<b>7,531,351</b>
3	Karburant	8,796,400
4	Service dhe pjese kembimi (2 Eskavator,Komioni,4 Motorcikleta)	856,000
5	Siguracione dhe kolaudim automjeti	109,000
6	Blerje materiale per infrastrukturen ujitese	591,600
7	Shpenzime te tjera	296,293
	<b>SHPENZIME TOTALE</b>	<b>10,649,293</b>

### Administrimi I pyjeve dhe kullotave 4260

NR.	PERSHKRIMI	Plani 2023
1	Paga	4,056,000
2	Sigurime	677,352
	<b>PAGA&amp;SIGURIME</b>	<b>8,094,311</b>
3	Karburant	516,000
4	Servis dhe pjese kembimi	97,500
5	Shpenzime per ZVRPP	85,000
	<b>SHPENZIME TOTALE</b>	<b>698,500</b>
	Pyllezim (Blerje Peme )	526,000
	<b>INVESTIME TOTALE</b>	<b>526,000</b>

Për ndjekjen dhe kryerjen e shpenzimeve është Drejtoria e Zhvillimit të Pyjeve, Bujqësisë dhe Veterinarisë, sektorët përkatës sipas programeve si dhe drejtuesi i programit.

- **Programi 045** Ky program përfshin: rrjetin rrugor, studimet rrugore dhe transportin publik.

**OBJEKTIVAT E KËTIJ PROGRAMI JANË:**

